

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-76/12**

**Prishtinë,  
17 janar 2013**

Në çështjen juridike të:

**E. Sh.**

**Xh. Xh.**

***Ankuesit***

kundër

**N. P.**

***Paraqitësi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/112/2011 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA 22024), i datës 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 janar 2013, morri këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1- Ankesa e paraqitur nga E. Sh. dhe Xh. Xh. hidhet si e palejuar për shkak të mungesës së interesit juridik.
- 2- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë) do të bartën nga palët ankuese (nga 30 € për secilin) dhe duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 11 dhjetor 2006, N. P. paraqiti kërkesë pranë Agjencionit Kosovarë të Pronave (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e pronës që gjendet në Jezavo, Viti (ngastra 395/3). Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se ai është bashkëpronar i ngastrës dhe se tani në të një person i panjohur ka ndërtuar depo për material ndërtimor. Kërkesa ishte regjistruar si KPA 22024.

Në mbështetje të kërkesës së vet, ai i siguroi AKP-së, Fletën Poseduese nr. 353, të lëshuar në emrin e babait të tij – N. D., nga ana e Institutit Serb të Gjeodezisë ( Republika e Serbisë, Instituti Republikan i Gjeodezisë) me 15 nëntor 1999, kopjen e planit kadastral në lidhje me ngastrën 395/3 dhe dokumente të tjera.

Sekretariati Ekzekutiv i njoftoi palët e treta të mundshme në lidhje me kërkesën, duke e vendosur njoftimin në atë pronë me 18 korrik 2008.

Askush nuk u përgjigj në kërkesë.

Me vendimin KPCC/D/A/112/2011 ( lënda e regjistruar pranë AKP-së me Nr. KPA 22024) të datës 22 qershor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) e pranoi kërkesën si të bazuar. Vendimi individual pasoi me 19 shtator 2011.

Me 31 maj 2012 E. Sh. dhe Xh. Xh. dorëzuan ankesë në Gjykatën Supreme. Ankesa nuk përmbante ndonjë argument, vetëm deklaratën se vendimi KKPK-së është i gabuar për shkak të mungesës së provave. Ankuesit paraqiten një kopje të padisë, në lidhje me rastin nr. 63, të datës 31 maj 2012, të dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Për shkak se ankesa nuk përmbante ndonjë indikacion sa i përket moskorrektësisë se vendimit të ankimuar, Gjykata ka pranuar se argumentet duhet të nxirren nga padia e paraqitur, e cila ishte dorëzuar pranë Gjykatës Komunale. Padia në fjalë është prej E. Sh. dhe Xh. Xh. kundër tre personave, njëri prej të cilëve është me emrin N.P.- paraqitësi i kërkesës, tani si palë përgjegjëse në ankesë në këtë procedurë. Sipas pjesës argumentuese të padisë së

paraqitur, E. Sh. është pronari faktik i ngastrës 394/0 dhe Xh. Xh. është pronari faktik i ngastrës 395/2. Pretendohet se ato ngastra janë blerë dhe se çmimi i tyre është paguar mirëpo asnjëherë nuk është arritur ndonjë kontratë e plotfuqishme ngase palët përgjegjëse nuk kishin ardhur kurrë në Kosovë. Më tej në petitumin e kësaj kërkesë është kërkuar nga Gjykata Komunale që të vërtetohet se paditësi E. Sh. dhe Xh. Xh. e kanë përparësinë në blerje të ngastrës 395/3, prandaj palët përgjegjëse janë të detyruar që së pari këtë tokë të ia ofrojnë për blerje me përparësi E. Sh. dhe Xh. Xh.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është e palejuar për shkak të mungesës së interesit juridik për ankimim ndaj vendimit të KKPK-së.

Sipas nenit 10.2 i UNMIK/REG/2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë do të jetë palë në procedurë pranë APK-së. *Per argumentum a contrario* personi pa interes juridik nuk do të jetë palë.

Ankuesit nuk pretendojnë se kanë të drejta ligjore ndaj ngastrës kontestuese Nr. 395-3. Ata vetëm e kanë shprehur dëshirën për ta blerë nga pronarët e vërtet (ashtu siç shihet qartë nga padia e dorëzuar pranë Gjykatës Komunale). Ata nuk e kontestojnë se e drejta e pronësisë i takon, në mes të tjerave, paraqitësit të kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë N. P. Sipas pjesës argumentuese të kërkesës së paraqitur E. Sh. është Kjo nënkupton se ata nuk kanë pasur interes juridik për të marrë pjesë në procedurë pranë AKP-së (ku edhe ashtu ata nuk kanë marrë pjesë) dhe për po të njëjtën arsye ata nuk kanë interes juridik për ta atakuar vendimin e kontestuar të KKPK-ë, ngase nuk ka të bëjë fare me të drejtat e tyre.

Ekzistimi i interesit juridik është parakusht procedural absolut për lejueshmërinë e një ankesë në procedurën civile në përgjithësi- neni 196 në lidhje me nenin 186.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili zbatohet pranë Gjykatës Supreme në procedurën e ankesave kundër vendimeve të AKP-së (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50). Ligji thekson se ankesa është e palejueshme në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik. Kërkesa për interes juridik qëndron gjatë tërë procedurës civile dhe zbatohet ndaj çdo pale. – arg. pas nenit 2. 4 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore. Ligji përcakton se pala duhet të ketë interes juridik në kërkesën e paraqitur dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë.

Për shkak se ankuesit nuk kanë interes juridik në këtë procedure, ankesa e tyre duhet të hidhet poshtë.

Mungesa e interesit juridik e bën të panevojshëm shpjegimin nëse ankesa është e pranueshme/papranueshme mbi bazën se pala ankuuese nuk ka marr pjesë në procedurë pranë shkallës së parë- ashtu siç është dashur.

Ankuesit pohojnë se ata i kanë paguar ngastrat fqinje -394/0 dhe 395/2 (për këtë ata i drejtohen vetvetes si “pronarë faktik”). Ata as që pretendojnë se janë bërë pronarë të ligjshëm të atyre tokave për shkak se ata nuk kanë qenë në gjendje që të nxjerrin ndonjë argument, qartazi ata kanë interes që të i “ mbulojnë” këto blerje në formë ligjore- duke arritur marrëveshje formale me shkrim, të arritura në përputhje me ligjin e aplikuar. Me gjasë ata kanë interes për ta blerë ngastrën fqinje -395/3 gjithashtu, mirëpo ky interes krejtësisht ekonomik nuk ndikon në të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit të KKKPK-së që i njeh të drejtën pronarit të vërtetë, prej të cilit ata mund të dëshirojnë që ta blejnë tokën.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, 10,15 dhe 10.1 të UA 2008/2): 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesit, nga 30 € për secilin ankues dhe duhet të paguhen ashtu siç është vendosur në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**